

TETOR 2024

MINISTRI I DREJTËSISË PREZANTON STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2024-2030

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, në praninë e drejtuesve të organeve të drejtësisë dhe përfaqësuesve diplomatike në Tiranë, prezantoi Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030. Ky dokument strategjik do të kontribuojë në forcimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, duke e përputhur atë me standardet evropiane. Kjo strategji është një hap i rëndësishëm për të avancuar reformat që janë ndërmarrë, për një drejtësi më të pavarur, transparente dhe të përgjegjshme për të gjithë qytetarët. Në prag të hapjes së negociatave me Bashkimin Evropian, Ministri Manja shprehu angazhim për: Konsolidimin e arritjeve të Reformës në Drejtësi: Sigurimi i zbatimit të vazhdueshëm të reformave në përputhje me standardet evropiane është një prioritet kyç. Forcimin e pavarësisë dhe llogaridhënies: Kjo strategji synon një sistem drejtësie që është i pavarur, transparent dhe përgjegjës ndaj qytetarëve, duke garantuar që të gjitha institucionet e drejtësisë të operojnë pa ndikime të jashtme. Rritjen e efikasitetit të institucioneve: Përmes modernizimit dhe digjitalizimit të shërbimeve, synohet të ofrohet një drejtësi më të shpejtë dhe efektive, që i shërben më mirë nevojave të qytetarëve. Zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore: Një komponent i rëndësishëm i strategjisë është zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore, e cila do të ndihmojë në organizimin dhe optimizimin e strukturave të gjyqësorit. Me këtë strategji, Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, dhe Ministria e Drejtësisë janë të përkushtuar për të sjellë drejtësinë evropiane më afër qytetarëve shqiptarë si kurrë më parë.



TAKIM ME MINISTRIN E DREJTËSISË SË ITALISË, CARLO NORDIO

Ky takim pasqyroj angazhimin e përbashkët për të thelluar bashkëpunimin në fusha kyçe të drejtësisë, duke shprehur vullnetin e përbashkët politik dhe duke forcuar marrëdhëniet historike mes vendeve tona, për të adresuar sfidat e përbashkëta të sundimit të ligjit dhe forcimit të shtetit të së drejtës. Gjatë takimit, u vendos që t'i jepet përparësi ndihmës juridike të ndërsjellë në luftën kundër krimit të organizuar transnacional dhe terrorizmit ndërkombëtar; në luftën kundër pastrimit të kapitaleve të paligjshme; trafikut të paligjshëm të qenieve njerëzore dhe drogës. Ministri Nordio konfirmoi mbështetjen e Italisë për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke kontribuar në përmirësimin e standardeve të drejtësisë dhe garantimin e sundimit të ligjit në vend. Palët ranë dakord për mundësinë e përditësimit dhe integritit të Memorandumit dypalësh të Mirëkuptimit të vitit 2017, si dhe për nisjen e negociatave në lidhje me: Formalizimin e parimit procedural Ne bis in idem në bashkëpunimin e ndërsjellë. Për një instrument të ri për njohjen reciproke të masave kufizuese të lirive personale, i ngjashëm me urdhër-arrestin evropian, i cili mund të zëvendësojë procedurën tradicionale të ekstradimit, në përputhje me kapitullin 24 të procesit të integritit evropian. Ky ishte takimi i dytë në nivel ministror mes Ministrit Manja dhe Ministrit Nordio, pas vizitës së Ministrit Manja në Romë në nëntor të vitit 2023, dhe dëshmon angazhimin e dyanshëm për të avancuar bashkëpunimin dhe për të përballuar sfidat e përbashkëta në fushën e drejtësisë.



MINISTERIALI I DREJTËSISË BE-BALLKANI PERËNDIMOR MANJA: TË ANGAZHUAR PËR NJË SISTEM DREJTËSIE ME STANDARDET EVROPIANE

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, në përfundim të Konferencës Ministeriale të Drejtësisë BE-Ballkani Perëndimor, që u zhvillua në Mal të Zi, shprehu angazhimin e Shqipërisë për ndërtimin e një sistemi drejtësie më efikas dhe gjithëpërfshirës. Konferenca u fokusua në drejtësinë digjitale, integrimin e Inteligjencës Artificiale dhe bashkëpunimin ndërkuftar në fushën penale. Ky event, i organizuar nga presidenca hungareze dhe i mikpritur nga Ministri i Drejtësisë të Malit të Zi, bashkoi Ministrat e Drejtësisë së Ballkanit dhe BE-në. Në fjalën e tij Ministri Manja theksoi se drejtësia digjitale dhe përdorimi i Inteligjencës Artificiale janë hapa të rëndësishëm në modernizimin e sistemit të drejtësisë, duke siguruar një akses më të lehtë dhe më efikas për qytetarët. Manja vuri në dukje sfidat e digitalizimit dhe nevojën për një kuadër ligjor të fortë me besimin se këto masa do forcojnë sistemin e drejtësisë dhe rrisin besimin e qytetarëve. "Me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës, Drejtësinë Elektronike dhe zhvillimin e kuadrit ligjor për Provat Elektronike, që pritet të hyjë në fuqi në 2026, jemi të angazhuar të ndërtojmë një sistem drejtësie transparent dhe gjithëpërfshirës", u shpreh Manja. Përfundimi me sukses i kësaj Konference Ministeriale përbën një hap të rëndësishëm në përpjekjet e Shqipërisë për të forcuar sistemin e saj dhe për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët. Shqipëria vazhdon të punojë ngushtë me partnerët ndërkombëtarë për të arritur këto objektivat ambicioze, duke e vendosur vendin në rrugën e modernizimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.



FORCOJMË BASHKËPUNIMIN SHQIPËRI-MALI I ZI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE TË BALLKANIT

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, ka përfunduar vizitën zyrtare në Mal të Zi, ku zhvilloi disa takime të rëndësishme me homologët e tij. Gjatë kësaj vizite, ai u takua fillimisht me Ministrin e Drejtësisë, Bojan Božović. Të dy ministrat u dakordësuan që pas publikimit të progres raportit të BE të organizonin takime periodike në nivel teknik dhe ekspertësh për kapitullin 23 të procesit të integritimit në BE, si në Tiranë ashtu edhe në Podgoricë. Ata u angazhuan për të ndarë përvoja dhe përmirësuar praktikatat në fushën e drejtësisë, me qëllim të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin midis dy vendeve. Në vijim të vizitës, Manja zhvilloi një takim me Ministrin e Administratës Publike, Marash Dukaj. Ata diskutuan për rëndësinë e përmirësimit të shërbimeve publike dhe digjitalizimin e administratës, duke theksuar nevojën për transparencë dhe efikasitet. U dakorduan për thellimin e bashkëpunimit në ndërtimin e një administrate moderne, e cila do të shërbejë më mirë për qytetarët dhe do të kontribuojë në një të ardhme më të mirë për të dy komunitetet. Kjo vizitë pasqyron përkushtimin e përbashkët të Shqipërisë dhe Malit të Zi për të forcuar marrëdhëniet dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një Ballkani më të fortë.

MANJA NË TRYEZËN ANTI-SLAPP: MBROJTMË LIRINË E FJALËS. GAZETARËVE DO T'U OFROJMË NDIHMË JURIDIKE FALAS

Me ftesë të SCIDEV, Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, ishte pjesë e tryezës së rrumbullakët "Harmonizimi i kuadrit ligjor të Shqipërisë me Direktivën anti-SLAPP të BE", e organizuar me mbështetje nga Ambasada Holandeze. Ky event u fokusua në mbrojtjen e gazetarëve nga paditë strategjike që kanë për qëllim t'i heshtin ata. Në fjalën e tij, Ministri i Drejtësisë theksoi disa nga masat që Ministria e Drejtësisë ka përfshirë në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës dhe Agjendën Kombëtare të

Reformave 2024-2027 për transpozimin e kësaj direktive, me qëllim garantimin e mbrojtjes ligjore për gazetarët dhe lirinë e medias. Një nga instrumentet e rëndësishme në këtë proces do të jetë ndihma juridike falas, e cila do të sigurojë akses të barabartë në drejtësi për gazetarët që përballen me paditë abuzive. Ministri Manja theksoi se me transpozimin e shpejtë të Direktivës anti-SLAPP dhe dekriminalizimin e shpifjes përmes miratimit të Kodit të ri Penal, synohet të krijohet një sistem drejtësie që garanton fuqishëm lirinë e shprehjes dhe të medias. Ky është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të mbrojtjes së gazetarëve dhe promovimit të një ambienti më të sigurt për lirinë e fjalës në Shqipëri.





MARRËVESHJE E RE SHQIPËRI-KOSOVË PËR NDËRMJETËSIMIN

Ministri i Drejtësisë së Shqipërisë, Ulsi Manja, mirëpriti Ministren e Drejtësisë së Kosovës, Albulena Haxhiu, në një takim që theksoi marrëdhëniet e shkëlqyera dhe angazhimin e përbashkët për forcimin e drejtësisë mes dy vendeve. Ky takim shënoi hapa të rëndësishëm drejt thellimit të bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë. Në qendër të bisedimeve ishte finalizimi i marrëveshjes teknike mes Dhomave të Ndërmjetësimit, e cila pritet të nënshkruhet deri në fund të muajit nëntor. Kjo marrëveshje do të krijojë një bazë të re bashkëpunimi, duke mundësuar shkëmbimin e ekspertizës dhe mbështetje për profesionistët e ndërmjetësimit në të dy vendet.

Ministrat gjithashtu diskutuan për përmbylljen e marrëveshjes mes dhomave të avokatisë, e cila synon të lehtësojë mundësitë për avokatët shqiptarë dhe kosovarë. Ky bashkëpunim do të forcojë lidhjet gjyqësore dhe do të garantojë standarde më të larta në fushat civile dhe penale për qytetarët e të dy vendeve. Angazhimi i dy ministrave është i orientuar drejt një partneriteti të qëndrueshëm dhe të thelluar, me qëllim që të sigurojë një qasje cilësore dhe të plotë në shërbimet e drejtësisë për qytetarët e Shqipërisë dhe Kosovës.

STUDENTËT E MAGJISTRATURËS VIZITOJNË MINISTRINË E DREJTËSISË, NË FOKUS ARRITJET E REFORMËS NË DREJTËSI

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, priti në Tiranë një grup studentësh të magjistraturës nga landi i Bavarisë, të udhëhequr nga gjyqtari z. Gernot Zehelin. Takimi u karakterizua nga një atmosferë e ngrohtë dhe ofroi një mundësi të veçantë për shkëmbimin e përvojave mes dy sistemeve të drejtësisë. Në qendër të diskutimeve ishte Reforma në Drejtësi, me fokus në procesin unik të vetingut – një nga arritjet kryesore që ka ndihmuar në forcimin e besimit publik dhe rritjen e transparencës në Shqipëri. Ministri Manja vuri në dukje edhe sfidat që kanë shoqëruar këtë reformë, duke nxitur një diskutim të frytshëm mbi praktikën më të mira për drejtësinë.

Ky takim theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për të promovuar dhe thelluar më tej reformën në drejtësi.



MANJA NDERON ME CERTIFIKATË PIONEREN E NDIHMËS JURIDIKE NË SHQIPËRI

Në një ceremoni të veçantë, në prani të përfaqësuesve nga shoqëria civile dhe sistemi i drejtësisë, Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, nderoi me certifikatën e mirënjohjes, znj. Rosemary French, presidenten dhe themeluesen e Benchmark Institute, për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në fushën e ndihmës juridike në Shqipëri. Certifikata iu dorëzua zëvendës presidentes së Benchmark Institute në nderim të punës së saj të palodhur. Ministri e cilësoi presidenten e ndjerë si një nga pioneret e ndihmës juridike falas në Shqipëri, duke theksuar se trashëgimia e saj vazhdon të jetojë.

Rosemary French vendosi gurin e themelit të këtij shërbimi 24 vite më parë, duke sjellë një qasje inovative për drejtësinë sociale në vendin tonë. Ky nderim është një reflektim i vlerësimit për angazhimin e saj të palodhur dhe ndikimin pozitiv që ka pasur në jetën e shumë individëve, duke ofruar mbështetje dhe mundësi për ata që kërkojnë drejtësi. Rosemary French do të kujtohet gjithmonë për përkushtimin e saj dhe kontributin e çmuar në ndihmën juridike në Shqipëri.



Ministria e Drejtësisë
Ulsi Manja



ministra_drejtisesise
ulsi manja



@manja_ulsi